

Ligjeratat e ardhëshme,
Kreu: V, VI,VII,VIII

V. CIKLI I BIZNESIT

Tema: CIKLET E BIZNESIT

Definimi :

- **Cikli I Biznesit prezanton tkurrjen ose zgjerimin e aktivitetit ekonomik rreth shtegut potencial.**

Fazat:

- **Pika më e lartë;**
- **Faza e recesionit (rënies ekonomike);**
- **Pika më e ulët; dhe**
- **Faza e ekspansionit (ngritjes ekonomike**

Ciklet e Biznesit

Ne periudhe afatshkurta


- Ne periudha afatshkurta PBB aktual mund të jetë mbi ose nën PBB potencial, luhatjet e tilla krijojnë **hendekun e prodhimit**.

Ne periudhe afatgjate

- Ekonomia I afrohet potencialit prodhues ($PBB_{aktual} = PBB_{potencial}$)




Cikli i biznesit




- Shikuar historikisht, ekonomia botërore ka pasur shumë faza të recesionit, si p.sh. ato të viteve:
1953/54, 1960/61, 1979/83, 1981/82, 2011/12, por si recesione më të thella janë të njohura ato të viteve 1929 /33, dhe 2007/09.
- Momenti kyç për të identifikuar ciklin e biznesit është përcaktimi i fazës së recesionit, pra moment në të cilin aktiviteti ekonomik është në rënie.
- ***Nëse recesioni (tkurrja) vazhdon në 2 e më shumë tremujore, ekonomia kalon në depresion, ashtu si në grafikun në vijim.***

Cikli i biznesit (kspansioni, pika më e lartë, recesioni dhe depresioni)



THE REAL ESTATE BUSINESS CYCLE

78 YEAR CYCLICAL WAVE
(52 YEARS OF ESCALATING TRENDS)



Copyright Martin Armstrong, 1979, 1985, 1989, 1999, 2009, 2011

- Momenti kyç për të identifikuar ciklin e biznesit është përcaktimi i fazës së recesionit, pra moment në të cilin aktiviteti ekonomik është në rënie.
- ***Nëse recesioni (tkurrja) vazhdon në 2 e më shumë tremujore, ekonomia kalon në depresion.***
- Gjatë periudhave të recesionit tkurrja e kërkesës redukton dhe ofertën për të mira dhe shërbime.
- Shumë biznese mbyllen dhe i largojnë punëtorët nga puna.
- Pas fazës më të ulët (recesioni), kërkesa fillon të rritet e cila stimulon ofertën dhe kërkon më shumë forcë punëtore.
- Ekonomia kalon në ekspansion dhe mund të përcillet edhe **me inflacion**.
- Faza e ekspansionit përfundon me pikën më të lartë në të cilën firmat punojnë me **kapacitete të plota prodhuese** dhe me **punëzënie të plotë**.

Tabela 15 Reduktimi i prodhimit industrial në SHBA në krizat ekonomike gjat periudhën 1890/2008


Viti	Rënia në %	Viti	Rënia në %
1890	- 5.3	1937	- 32.5
1893	- 17.3	1945	- 35.5
1895	- 10.8	1948	- 10.1
1899	- 10.0	1953	- 9.5
1902	- 9.5	1957	- 13.6
1907	- 20.1	1960	- 8.6
1910	- 9.1	1969	- 7.0
1913	- 12.1	1973	- 13.1
1918	- 6.2	1980	- 6.6
1920	- 32.5	1981	- 9.4
1923	- 16.0	1990	- 4.1
1926	- 6.0	2001	- 6.2
1929	- 53.6	2008	-

Vazhdim i tabelës 14

Nëndor, 1927	21	Gusht, 1929	43 (depresioni)
Mars, 1933	50	Maj, 1937	13 (depresioni)
Qershor, 1938	80 (Lufta II Botrore)	Fror, 1945	8
Tetor, 1945	37	Nëndor, 1948	11
Tetor, 1948	45 (Lufta e kores)	Qershor, 1953	10
Maj, 1954	39	Gusht, 1957	8
Prill, 1958	24	Prill, 1960	10
Fror, 1961	106 Lufta në Vietnam	Dhjetor, 1969	11
Nëndor, 1970	36	Nëndor, 1973	16
Mars, 1975	58	Janar, 1980	6
Korrik, 1980	12	Korrik, 1981	16
Nëndor, 1982	92	Qershor, 1990	8
Mars, 1991	120	Mars, 2001	8
Mars, 2001		Nëdor, 2001	8
Shtator, 2007	73	Qershor, 2009*	18

Grafiku 16

Cikli i biznesit dhe ecuritë e PBB real, papunësisë dhe inflacionit nëpër fazat e tij



Dy kriza globale ekonomike (recesione me te thella) me te thekësuar:

- 1929/33 (Franklin Ruzvelt – Mew Deal)
- 2007/09
- **Prodhimi industrial** llogaritet si indikator më relevant për të matur efektet e cikleve të biznesit. Çdo recesion ose depresion rezulton me rënien e prodhimit industrial dhe anasjelltas.
- Intensiteti i ndryshimeve në prodhimin industrial ishte pasoj e veprimit të politikave qeveritare **mbi ciklet e biznesit**

Tabela 15 Reduktimi i prodhimit industrial në SHBA në krizat ekonomike gjat periudhën 1890/2008

Viti	Rënia në %	Viti	Rënia në %
1890	- 5.3	1937	- 32.5
1893	- 17.3	1945	- 35.5
1895	- 10.8	1948	- 10.1
1899	- 10.0	1953	- 9.5
1902	- 9.5	1957	- 13.6
1907	- 20.1	1960	- 8.6
1910	- 9.1	1969	- 7.0
1913	- 12.1	1973	- 13.1
1918	- 6.2	1980	- 6.6
1920	- 32.5	1981	- 9.4
1923	- 16.0	1990	- 4.1
1926	- 6.0	2001	- 6.2
1929	- 53.6	2008	-

- Përveç prodhimit industrial, si indikator relevant për prezantimin e cikleve
 - të biznesit mund të merret PBB real me elementet e tij përbërëse
 - (konsumi, investimet, shpenzimet qeveritare dhe eksporti neto).
-
- Në tkurrjen e ekonomisë zvogëlohen të ardhurat e popullsisë vendase, sepse punësime të reja nuk ka dhe një pjesë e të punësuarve largohen nga puna, trendet e tilla rezultojnë me zvogëlimin e konsumit të të mirave dhe shërbimeve. Në rrethana të tilla, zgjidhja gjendet në eksport. Reduktimi i eksportit në ekonominë amerikane mund të rezultojë nga recesionet e ekonomive tjera.

Tabela 16 - Reduktimi i PBB real dhe ecuria e përbësve të tij, në SHBA në periudhën 1948/2001

	PBB real, (në %)	C	I	G	Nx
Tremujori i IV 1948		+			
Tremujori i IV 1949	- 24.9	33.1	- 52.5	+ 20.6	- 3.1
Tremujori i III 1953					
Tremujori. i II 1954	- 51.2	+ 8.8	- 25.5	- 49.8	+ 7.9
Tremujori i III 1957					
Tremujori. i I 1958	- 1.5	- 17.6	- 38.9	+ 4.1	- 11.8
Tremujori i III 1960					
Tremujori. i IV 1960	- 38.1	+ 14.3	- 65.8	+ 24.3	+ 13.3
Tremujori i III 1969					
Tremujori. i IV 1970	- 21.8	+ 55.9	- 56.2	- 24.2	+ 9.2
Tremujori i IV 1973					
Tremujori. i I 1975	- 114.1	- 26.8	- 164.5	+ 32.4	+ 40.6
Tremujori i I 1980					
Tremujori. i II 1980	- 101.1	- 73.2	- 64.3	+ 3.1	+ 31.8
Tremujori i I 1981					
Tremujori. i I 1982	- 118.2	+ 11.2	- 91.5	+ 6.1	- 13.0
Tremujori i II 1990					
Tremujori. i II 1991	- 100.3	- 41.3	- 117.9	+ 20.0	+ 48.5
Tremujori i IV 2000					
Tremujori. i III 2001	- 57.4	+ 82.1	- 192.5	+ 39.9	- 6.5

Tabela 17 - Lëvizjet ciklike në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar në periudhën 1812 - 2012

Emërtimi	Data	Zgjatja (në vite)	Reduktimi i PBB (në %)	Shkaqet
Mbas depres. të luft. të Napolon.	1812 - 1821	- 9		Përshat. pas luftës
Recesioni (1957/58)	1857 - 1858	-1	- 1	Me origjin nga SHBA. Paniku i vitit 1857. Kriza
Recesioni (1867/69)	1867 - 1869	-2	- 1	Ndikimi i eksportit nga recesi.amerikan pas Luftë civile
Depres.i gjatë	1873 - 1896	- 20	Deflacion por jo turrje e PBB	Paniku i vitit 1873
Depresioni (1919/21)	1919 - 1921	- 3	10.9 (1919), 6.0 (1920) dhe 8.1 (1921)	Fundi i Luftë së I Botërore.
Depresioni i thellë	1930 - 1931	- 2	0.7 (1931), dhe 5.1 (1931)	Depres. në SHBA, reduktimi i kërkes për eksp Angleze
Recesioni (1956)	Tremujori i II dhe i III i vitit 1956	- 0.5	0.3	Recesioni i vitit 1956
Recesioni (1961)	Tremujori I II dhe i III I vitit 1961	- 0.5	0.5	Recesioni i vitit 1961

Vazhdim i tabelës 17

Recesioni në mesin e vitit 70	Tremujori i III i 1973, Tremuj. i I 1974, Tremuj. i II dhe III.1975	- 1	5.1	Kriza e vajit në vitin 1973
Recesioni i vitit 1980	Tremujori i I, 1980, Ttrem. I 1981	- 1.25	4.6 dhe 3.8 %	
Recesioni i vitit 1990	Tremujori i III 1990 gjer në tre m. e I1991	- 1.25	2.4	Kriza e vitit 1990 në ekon. e SHBA
Kriza e thellë ekonomike (2007/09)	Tremujori i II 2008 gjer më trem e III 2009	- 1.5	7.2	Kriza e tregjeve financ. në SHBA
Kriza ekon. reces i dyfishtë më 2011 , 2012	Tremuj. i IV 2011 gjer më trem. e II 2012	- 0.75	0.6	Kriza e borxheve në Europë

Tabela 18 - Rritja ekonomike para krizës dhe gjat krizës (2007/09) në disa shtete të botës

	Rritja ekonomike para krizës, (2005/07)	Rritja ekonomike gjat krizës, (2008)	2009
Italia	1.3	- 1.4	- 2.1
Japinia	2.1	- 1.5	- 2.6
Britan . Madhe	2.6	- 1.1	- 2.8
Gjermania	2.1	- 0.6	- 2.5
Franca	2.1	- 0.3	- 1.9
SHBA	2.6	- 0.4	- 1.6
Korea e Jugut	4.8	- 0.6	- 4.0
Kanadaja	2.9	- 0.3	- 1.2
Spanja	3.7	- 0.3	- 1.7
Meksika	3.7	0.8	- 0.3
Rusia	7.3	2.8	- 0.7
India	9.4	6.2	5.1
Kina	11.3	7.9	6.7
Brazili	4.1	3.8	1.8

Tabela 19 - Veprimi kohor i krizës financiare botërore 2007/09 dhe ajo e viteve 2011/13

Shqipëria	Tm 1 – 2007 deri më Tm 2 2007 (6 muaj) Tm 3 – 2009 deri më Tm 4 2009 (6 muaj) Tm 4 – 2011 deri më Tm 2 2012 (6 muaj)	Irlanda	Tm 2 – 2007 deri më Tm 3 2007 (6 muaj) Tm 1 – 2008 deri më Tm 4 2009 (24 muaj)
Austria	Jo	Luksembur	Tm 2 – 2008 deri më Tm 2 2009 (15muaj)
Begjika	Tm 3 – 2008 deri më Tm 1 2009 (9 muaj) Tm2 – 2012 deri më Tm120013 (12 muaj)	Italia	Tm 2 – 2008 deri mëTm 2 2009 (15muaj) Tm 3 – 2011 deri ... (27 muaj)
Bullgaria	Tm 1 – 2009 deri më Tm 2 2009 (6 muaj)	Moldavia	Jo
Kina	jo	Polonia	Jo
Repubika Çeke	Tm 1 – 2008 deri më Tm 4 2009 (9 muaj) Tm 1 – 2011 deri më Tm 4 2011 (16 muaj)	Japonia	Tm 2 – 2008 deri më Tm 1 2009 (12muaj) Tm 4 – 2010 deri mëTm 2 2011 (9 muaj) Tm2 – 2012 deri më Tm3 2012 (6 muaj)
Danimarka	Tm 3 – 2008 deri më Tm 2 2009 (12 muaj) Tm 3 – 2011 deri më Tm4 2011 (6 muaj) Tm4 – 2012 deri më Tm1 2013 (6 muaj)	Noirvegjia	Tm 1 – 2009 deri më Tm 2 2009 (6 muaj) Tm 2 – 2010 deri më Tm 3 2010 (6 muaj) Tm 1 – 2011 deri më Tm 2 2011 (6 muaj)

Vazhdim i tabelës 19

Estonia	<p>Tm 3 – 2008 deri më Tm 3 2009 (15 muaj)</p> <p>Tm 1 – 2013 deri më Tm 2 2013 (6 muaj)</p>	Maqedonia	<p>Tm 1 – 2009 deri më Tm 3 2009 (9 muaj)</p> <p>Tm 1 – 2012 deri më Tm 3 2012 (6 muaj)</p>
BE(28 sht. antare)	<p>Tm 2 – 2008 deri më Tm 2 2009 (15 muaj)</p> <p>Tm 4 – 2011 deri më Tm 2 2012 (9 muaj)</p> <p>Tm 4 – 2012 deri mëTm 1 2013 (6 muaj)</p>	Sërbia	<p>Tm 2 – 2008 deri më Tm 2 2009 (15 muaj)</p> <p>Tm 2 – 2011 deri më Tm 2 2012 (12 muaj)</p> <p>Tm 3 – 2012 deri më Tm 4 2013 (6 muaj)</p>
Eurozona 17sht ant.	<p>Tm 2 – 2008 deri mëT m 2 2009 (15 muaj)</p> <p>Tm4 – 2011 deri m ëTm 1 2013 (16 muaj)</p>	Spanja	<p>Tm 2 – 2007 deri më Tm 2 2009 (21 muaj)</p> <p>Tm 2 – 2011 deri më Tm 2 2013 (6 muaj)</p>
Finlanda	<p>Tm 1 – 2008 deri më Tm 2 2009 (15 muaj)</p> <p>Tm 2 – 2012 deri mëTm 1 2013 (12 muaj)</p>	Urugvaj	Jo
Franca	<p>Tm 2 – 2008 deri më Tm 2 2009 (15 muaj)</p> <p>Tm 4 – 2012 deri më Tm 1 2013 (6 muaj)</p>	Australia	<p>Tm 2 – 2008 deri më Tm 2 2009 (12 muaj)</p> <p>Tm3 – 2011 deri më Tm 4 2011 (6 muaj)</p>

Vazhdim i tabelës 19

G 20	Tm 3 – 2008 deri më Tm 1 2009 (9 muaj)	SHBA	Tm 3 – 2009 deri më Tm 2 2009 (12 muaj)
Gjermania	Tm 2 – 2008 deri më Tm 1 2009 (12 muaj)	Rusia	Tm 3 – 2008 deri më Tm 3 2009 (12 muaj)
Greqia	Tm 3 – 2008 deri më Tm 2 2014 (63 muaj)	Zvicra	Tm 4 – 2008 deri më Tm 1 2009 (6 muaj)
Islanda	Tm 4 – 2007 deri më Tm 2 2008 (9 muaj) Tm 4 – 2008 deri më Tm 1 2009 (6 muaj) Tm 3– 2011 deri më Tm 2 2013 (15 muaj)	Sllovenia	Tm 3 – 2008 deri më Tm 2 2009 (12 muaj) Tm 4 – 2009 deri më Tm 2 2009 (9 muaj) Tm 3 – 2011 deri më Tm 4 2013 (24 muaj)
India	Jo	Sllovakia	Jo
Indonezia	Jo	Korea Jug.	Jo

Parashikimet e Cikleve të Biznesit!

- Sipas Byrosë Ekonomike Amerikane, porositë e reja për të mira dhe shërbime të konsumit të amvisërive, investimeve kapitale, lejet e ndërtimit, çmimet e aksioneve, sigurimet etj., mund të jenë sinjale të forta për ecuritë cikleve ekonomike.
- *Për këtë arsye pika më e lartë e papunësisë quhet tregues i vonuar i cikleve të biznesit. Në krizën e fundit botërore e cila zgjati nga dhjetori i vitit 2007 deri në qershor të vitit 2009, **Byroja Ekonomike Amerikane** recesionin e shpalli më 29 prill 2008 dhe po këtë vit u mbyllën 2.6 milion vende pune. Në qershor të vitit 2009 kur recesioni u shpall i mbaruar, papunësia krahasuar me dhjetorin e vitit 2007 kur filloi recesioni u rrit për 5.1 milion persona. Pra kjo tregon se normat e larta të papunësisë mund të jenë tregues të vonuar të cikleve të biznesit.*

INDIKATORËT MAKROEKONOMIK DHE CIKLI I BIZNESIT

- ***Punësimi është prociklik sepse me rritjen ekonomike rritet punësimi dhe anasjelltas.***
- ***Papunësia është jo ciklike sepse me rritjen ekonomike ulet papunësia dhe anasjelltas.***
- ***PBB, konsumi dhe investimet janë prociklike. Me rritjen ekonomike,***
rriten të mirat dhe shërbimet, rritet punësimi i cili rrit konsumin dhe kërkesa e rritur imponon nevojën për rritjen e investimeve. Me fjalë të tjera rritja e tyre lëviz ekonominë drejt prosperitetit, përkundrazi tkurrja e treguesve të sipërpërmendur lëviz ekonominë në drejtim të recesionit.
- ***Shpenzimet qeveritare më shumë prirën të jenë prociklike, sepse me rritjen ekonomike të hyrat buxhetore janë më të larta dhe me tkurrjen e ekonomisë ato zvogëlohen.***

Vazhdim...

- ***Produktiviteti i punës është prociklik, sepse me rritjen ekonomike rriten*** sasitë e prodhuara për njësi kohe dhe anasjelltas.
- ***Çmimet e aksioneve dhe oferta për para janë prociklike dhe udhëheqin ciklet.***
- ***Me rritjen ekonomike fitohet më shumë, sepse rritet besimi dhe çmimet*** e aksioneve rriten dhe anasjelltas ***Me rritjen ekonomike rriten të mirat dhe shërbimet të cilat për t'u këmbyer nevojiten para, prandaj masa e tyre rritet*** dhe me rënien ekonomike punët lëvizin në drejtim të kundërt.
- ***Normat e interesit janë jociklike, sepse me rritjen ekonomike ato bien*** dhe anasjelltas. Me rënien ekonomike, bankat nga rreziku rrisin normat e interesit dhe vështirsojn kushtet e marrjes së kredive. Në prosperiten ekonomik punët lëvizin në drejtim të kundërt.

- Siç mund të vërehet, analiza e raportit midis papunësisë dhe rritjes ekonomike ka një peshë të veçantë për lëvizjet ciklike të ekonomisë. Me hulumtimin e një raporti të tillë është marr **Okuni**.
- Sipas tij, kur norma e rritjes është mbi ritmin e prirjes prej 2.25 %, norma e papunësisë bie.
- Me fjalë të tjera, kur ekonomia shënon rritje prej 1 % mbi ritmet e prirjes prej 2.25 % papunësia zvogëlohet për 0.5 %.
- Ligji i Okunit, prezanton një rregull praktik të konvertimit të rritjeve ekonomike dhe reduktimit të normave të papunësisë

- Nobelisti, Pol Samuelson zhvilloj modelin e **akcelatorit (përsheptimit)** dhe **multiplikatorit (shumëzimit)**.
- Akcelatorin dhe multiplikatorin i kemi analizuar dhe më parë (kërkesa agregate), por vlerësojmë se nuk është e tepërt t'i rikujtojmë dhe një herë dhe të njihemi për efektet e tyre në lëvizjet ciklike të ekonomisë.
- ***Akcelatori tregon ndikimin e të ardhurave në investime.***
- ***Me aktin e investimeve fillon edhe veprimi i multiplikatorit.***
- Nocionin e multiplikatorit në terminologjinë ekonomike e përdori profesori Kan në vitin 1931. Ai qeverinë e sheh si organizator të punëve
- publike (rrugë, penda, sistem ujitje, etj.)
-
- ***Me aktivitetet e mësipërme qeveria punëson punëtorë të rinj të cilët ekonomisti Kan i quan punë parësore-dytësor....***
- ***Multiplikatori prezanton raportin e investimeve dhe të ardhurave, këto të fundit rriten më shpejtë.***

ECURITË CIKLIKE TË EKONOMISË SIPAS KEJNSIT

- *Arsyen kryesore të tkurrjes ekonomike Kejnsi e kërkon në reduktimin e investimeve, të cilat janë pasojë e rënies së efikasitetit marxhinal të kapitalit.*
- Sipas Kejnshit efikasiteti marxhinal i kapitalit është nën ndikimin e fuqishëm të pritjes së bizneseve për rrjedhat e ardhshme ekonomike.
- Në periudhën e recesionit të biznesit, dominon ***pesimizmi i cili frenon investimet kapitale***, të cilat tkurrin kërkesën agregate.
- Përkundrazi, kur rritet kërkesa agregate, ekonomia shënon rritje dhe dominon ***optimizmi i cili rrit investimet***. Zgjerimet e aktiviteteve ekonomike shoqërohen me shfrytëzim racional të resurseve dhe norma të ulëta të papunësisë.
- *Siç mund të vërehet, sipas Kejnshit, ndryshimet e kërkesës agregate janë burimi kryesor i shfaqjes së cikleve të biznesit.*

Teoritë e cikleve të biznesit


- Teoria monetariste, me përfaqësuesin e saj nobelistin Milton Fridman
- Teoria e befasisë monetare e mbështetur nga neoklasikët, shfaqjen e cikleve të biznesit e lidhin me pritjet racionale
- Ciklet e biznesit shfaqen në rastet kur Banka Qendrore rrit sasinë monetare në mënyrë jo transparente dhe pa e informuar realisht publikun.
- *Teoria e cikleve reale të biznesit, shfaqjen e tij e kërkon në anën e ofertës.*

VI KONSUMI, KURSIMET DHE INVESTIMET

- Konsumi i amvisërive paraqet indikatorin teje të rëndësishëm të kërkesës agregate. Siç kemi cek më parë, ai përfshin $\frac{3}{4}$ e PBB dhe ka ndikim të fuqishëm në ecuritë ekonomike.
- ***Vendimi i familjes për nivelin e konsumit njëkohësisht paraqet edhe vendimin për kursim, sepse pjesa e të ardhurave e cila nuk konsumohet do të kursehet.***
- Shtrohet pyetja: a do të shpenzohen të gjitha të ardhurat kombëtare për t'i blerë të mira dhe shërbime ose një pjesë e tyre do të kursehen dhe sa do jetë niveli i këtyre indikatorëve?

Grafiku 17


Skema e qarkullimit të të ardhurave dhe shpenzimeve



- ***Kursimi i nxjerr mjetet financiare nga qarku dhe ato zakonisht depozitohen në banka për të marrë të ardhura nga norma e interesit.***
- Supozojmë se firma ka investuar 200 \$ për të angazhuar një punëtor dhe një veprim i tillë ka derdh mjetet financiare në qarkun e të ardhurave. Nëse punëtori këto të ardhura (200 \$) i kursen, një veprim i tillë i nxjerr parat nga qarku.
- **Së pari të ardhurat mund të dalin nga skema e qarkullimit dhe nuk do të arrijnë te firmat e biznesit, si kërkesë për të mirat dhe shërbimet e tyre për 3 arsye:**
 - ***Sepse një pjesë e tyre kursehet***
 - ***Taksat qeveritare***
 - ***Të mirat dhe shërbimet e importuara***

Grafiku 18

Prurjet dhe derdhjet në qarkun e të ardhurave kombëtare



- *Siç mund të vërejmë nga pjesa e epërme e grafikut, tatimet dhe taksat (T) paraqesin të hyrat shtetërore.*
- Në Sektorin e biznesit prurjet dhe derdhjet në qarkun e të ardhurave prezantohen nëpërmjet kursimeve (S) dhe investimeve (I).
- ***Në sektorin e tregtisë së jashtme prurjet dhe derdhjet në qarkun e të ardhurave prezantohen nëpërmjet importit dhe eksportit, diferenca midis tyre quhet neto eksport (Nx).***

TË ARDHURAT DISPONUERE

- Të ardhurat disponuese (Y_d) ose konsumohen (C) ose kursehen (S). Nëse jemi të prirë për konsum mund të kursejmë më pak dhe anasjelltas. Nga ajo që u çek më sipër, mund të prezantojmë identitetin e të ardhurave disponuese, ai është si më poshtë:

$$Y_d = C + S$$

Identiteti tregon se konsumi dhe kursimet varen nga niveli i të ardhurave, nga niveli i të ardhurave varet kërkesa agregate dhe investimet.

- Shtetet e zhvilluara me të ardhura të larta kanë mundësi më të mëdha për konsum dhe kursim më të lartë, ndërsa shtetet jo mjaft të zhvilluara karakterizohen me nivele më të ulëta të konsumit dhe të kursimeve.

Funksioni i konsumit (consumption function) tregon raportin midis nivelit të konsumit dhe nivelit të të ardhurave.

Sipas Kejnshit funksioni i konsumit është : $C = C_0 + MPC (Y)$.

Simbolet shprehin: C_0 – Shpenzimet autonome ose Shpenzimet qeveritare, MPC – Prirja marxhinale për konsum (Marginal propensity to consume), Y – Të ardhurat disponuese.

Prirja marxhinale për konsum (MPC) tregon pjesën shtesë të konsumit e cila rezulton nga pjesa shtesë e të ardhurave. $MPC = \Delta C / \Delta Y$. Prirja marxhinale për kursim (MPS) tregon pjesën shtesë të kursimit e cila rezulton nga pjesa shtesë e të ardhurave

($MPS = \Delta S / \Delta Y$).

- Koeficienti i prirjes marxhinale për konsum dhe prirjes marxhinale për kursim është çdo herë i barabartë me 1 ($MPC + MPS = 1$).
- Shprehja tregon se në 1 \$ sa është prirja marxhinale për konsum dhe sa për kursim.

Tabela 20 Prirja marxhinale për konsum (MPC) dhe prirja marxhianle për kursim(MPS)

	Yd	S	C	MPC	MPS
A	10.000	- 200	10.200	----	-----
B	11.000	0	11.000	800 / 1000 = 0.80	200 / 1000 = 0.20
C	12.000	250	11.750	750 / 1000 = 0.75	250 / 1000 = 0.25
D	13.000	550	12.450	700 / 1000 = 0.70	300 / 1000 = 0.30
E	14.000	900	13.100	650 / 1000 = 0.65	350 / 1000 = 0
F	15.000	1.300	13.700	600 / 1000 = 0.60	400 / 1000 = 0.40
G	16.000	1.750	14.250	550 / 1000 = 0.55	450 / 1000 = 0.45
M	17.000	2.250	14.750	500 / 1000 = 0.50	500 / 1000 = 0.50

KONSUMI DHE KARAKTERISTIKAT STRUKTURETË TIJ

- Konsumi përfshin atë pjesë të të ardhurave disponuese të cilën familjet e shpenzojnë për të blerë të mira dhe shërbime të ndryshme (ushqim, tesha, shtëpi, makina, libra, etj.)
- Shkenca ka vërtetuar se: *në familjet e varfra, ushqimi dhe teshat përfshijnë pjesën më të madhe të të ardhurave, (shtetet e Afrikës).*
- *Ndryshimet në strukturën e konsumit me kalimin e kohës mund të hasim në të njëjtën ekonomi kombëtare.*

KUPTIMI I KURSIMIT


- Me kursim heqim dorë nga konsumi i tanishëm për ta rritur atë në ardhmen, p.sh. kursimi në moshën e re do të rrisë konsumin në moshën e vjetër.
- Në jetën e përditshme shumë familje të cilat marrin të ardhura të ulëta jo vetëm që nuk mund të kursejnë, por për të plotësuar nevojat elementare ato marrin hua. ***Huaja ndryshe quhet kursim negativ.***
- Funksinin e konsumit (*consumption function*) e analizoi ekonomisti i famshëm Xhon Majnard Kejnsi. ***Ai tregon raportin midis nivelit të konsumit dhe nivelit të të ardhurave.*** Funkzioni i konsumit është si më poshtë:

$$C = C_0 + MPC (Y)$$

- Shprehjet paraqesin:
- ***C₀*** – ***Shpenzimet autonome,***
- ***MPC*** – ***Prirja marxhinale*** për konsum (Marginal propensity to consume),
- ***Y*** – ***Të ardhurat disponuese.*** Shpenzimet autonome
- ***(C₀)***, janë shpenzimet qeveritare të cilat nuk
- ndryshojnë me ndryshimin e të ardhurave disponuese.


Grafiku 19

Funksioni i konsumit (të dhënat e tabelës paraprahe)



Grafiku 20

Funksioni i kursimit (të dhënat e tabelës paraprahe)



Faktorët determinues të konsumit dhe kursimeve


- *Pasuria*
 - *Pritjet për ecuritë vijuese të çmimeve*
 - *Huat e marra*
 - *Tatimet*
-
- Teoria e ciklit jetësor të konsumit dhe kursimeve analizon shpërndarjen e konsumit personal gjatë gjithë jetës.
-
- **Teoria e të ardhurave permanente**
 - **$C = c YP$**
- Simbolet tregojnë: C, konsumin, c – prirjen marxhinale për konsum, YP - të ardhurat permanente.

INVESTIMET DHE FAKTORËT DETERMINUES

- Firmat e biznesit të cilët janë bartës të investimeve në vendimet e tyre për zgjerim aktiviteti kanë mundësi të ndryshme. Bizneset vendosin të investojnë kur të ardhurat e realizuara janë më të larta nga investimet.
- Normat e interesit dhe investimet e planifikuara kanë raport invers mes veti. Ky raport mund të vërehet nga kurba me pjerrtësi zbritëse e kërkesës për investime në grafikun e më poshtëm.

Grafiku 21

Kurba e kërkesës për investime



- ***Kursimet*** u japin nxitje investimeve dhe ato mes veti kanë lidhje të forta korelative.
- ***Pritjet e bizneseve*** për kërkesat e të mirave dhe shërbimeve të tyre janë faktor determinues për investimet e planifikuara.
- ***Avancimet teknologjike*** rrisin produktivitetin dhe shtojnë fitimet e bizneseve. Këto të fundit, stimulojnë investimet e reja në resurset humane, *robotë, teknologji të reja, etj.*
- ***Politika tatimore mund të rrisë ose të zvogëlojë shpenzimet për investime.*** Norma e lartë tatimore dekurajonë firmat e biznesit për investime dhe anasjelltas.

FAKTORËT DETERMINUES

- ***Kursimet*** u japin nxitje investimeve dhe ato mes veti kanë lidhje të forta korelative.
- ***Pritjet e bizneseve*** për kërkesat e të mirave dhe shërbimeve të tyre janë faktor determinues për investimet e planifikuara.
- ***Avancimet teknologjike*** rrisin produktivitetin dhe shtojnë fitimet e bizneseve. Këto të fundit, stimulojnë investimet e reja në resurset humane, robotë, teknologji të reja, etj.
- ***Politika tatimore mund të rrisë ose të zvogëlojë shpenzimet për investime.*** Norma e lartë tatimore dekurajonë firmat e biznesit për investime dhe anasjelltas.

Tabela 22 Efikasiteti i investimeve në disa shtete selektive

	Investimet (% e PBB)	Rritja e PBB (në %)	Shpenzimet e ekon. Komb. (I : II),	Efikasiteti i investimeve (II : I)
Shqipëria	24.2	2.1	11.6	0.09
Gjermania	17.7	1.4	12.6	0.08
Maqedonia	21.8	3.4	6.4	0.15
Norvregjia	26.9	1.8	14.9	0.07
Bosn &He	19.8	1.0	19.8	0.05
Greqia	13.8	0.6	23.0	0.04
Suedia	19.9	2.1	9.5	0.11
Zvicra	21.5	2.1	10.3	0.10
Turqia	19.9	3.0	6.6	0.15
Rusia	20.5	0.5	41.0	0.02
Bullgaria	23.8	1.4	17.0	0.06
Austria	20.9	1.0	20.9	0.05
Kina	47.8	7.4	6.5	0.15
India	32.2	5.8	5.6	0.17
Japonia	22.2	1.3	171	0.05
SHBA	19.8	24.0	8.3	0.12

Tabela 23 Ekspansioni, ekuilibri dhe tkurrjet në një ekonomi të modelit të thjeshtë ($Y = C + I$)

(1) Y – Të ardhururat Kombët. (AS)	(2) C – Konsumi i planifikuar	(3)= (1 –2) S – Kursimi i planifikuar	(4) I – Investimi planifikuar	(5) = (2 + 4) – 1 Ndrysh. e pa- planifikuar	(6) = (2)+ (4) Kër. Agreg (AD)	Ekspansioni ekuilibri tkurrja (6 – 1)
5000	5200	- 200	200	- 400	5400	Ekspan.
5500	5600	- 100	200	- 300	5800	Ekspan.
6000	6000	0	200	- 200	6200	Ekspan.
6500	6400	100	200	- 100	6600	Ekspan.
7000	6800	200	200	0	7000	Ekuilibri
7500	7200	300	200	100	7400	Tkurrje
8000	7600	400	200	200	7800	Tkurrje
8500	8000	500	200	300	8200	Tkurrje
9000	8400	600	200	400	8600	Tkurje

Tabela 24 - Ekspansioni, ekuilibri dhe tkurrja në një ekonomi të mbyllur ($Y = C + I + G$)

(1) Y – Të ardhur. kom (oferta agr.)	(2) Tatim	(3)= (1- 2) Të ardh. Dispon.	(3) C Kons.	(4) I Invest.	(5) G Shpnz. Qever.	(7) Kërk. Agreg. C+I+G	Ekspans.Ek uilibri Tkurrje (7 – 1)
5000	100	4900	5100	200	100	5400	Ekspan.
5500	100	5400	5500	200	100	5800	Ekspan.
6000	100	5900	5900	200	100	6200	Ekspan.
6500	100	6400	6300	200	100	6600	Ekspan.
7000	100	6900	6800	200	0	7000	Ekuilibri
7500	100	7400	7100	200	100	7400	Tkurrje
8000	100	7900	7400	200	200	7800	Tkurrje
8500	100	8400	7700	200	300	8200	Tkurrje
9000	100	8900	8000	200	400	8600	Tkurje

Tabela 25 Eekspansioni, ekuilibri dhe tkurrja në një ekonomi të hapur ($Y = C + I + G + Nx$)

(1) Y – Të ar- Kom Ofer. ag.	(2) T Tatim.	(3)= (1 -2) Yd Të ardh. disponu	(4) C Kons	(5) S Kurs	(6) I Inves	(7) G Shp. Qev.	(8) Neto Exp.	(7) AD = C+I+ G+Nx	Ekspans.E kuilibri Tkurrjet (9 – 1)
5000	100	4900	5100	-200	200	100	- 50	5350	Ekspan.
5500	100	5400	5500	- 100	200	100	- 40	5760	Ekspan.
6000	100	5900	5900	0	200	100	- 30	6170	Ekspan.
6500	100	6400	6300	100	200	100	- 20	6580	Ekspan.
7000	100	6900	6800	200	200	0	0	7000	Ekuilibri
7500	100	7400	7100	300	200	100	+ 30	7430	Tkurrje
8000	100	7900	7400	400	200	200	+ 40	7840	Tkurrje
8500	100	8400	7700	500	200	300	+ 50	8250	Tkurrje
9000	100	8900	8000	600	200	400	+ 60	8660	Tkurje

Të ardhurat disponuese

- $YD = Y + TR - TA$, (Yd = të ardhurat e disponueshme, Y – të ardhurat, T transfertat, TA – taksat).
- Meqë të ardhurat e disponueshme prezantojnë konsumin dhe kursimin ($YD = C + S$), me kombinimin e dy identiteteve fitojmë: $C + S = YD = Y + TR - TA$ ose $C = YD - S = Y + TR - TA - S$.
- Nga identiteti i fundit pamë se konsumi është i barabartë me të ardhurat e disponueshme minus kursimet ose me të ardhurat plus transferet, minus taksat dhe kursimet. Duke kombinuar identitetin e fundit me identitetin e ekonomisë së hapur, $Y = C + I + G + Nx$ dhe duke zbatuar disa transformime, vijmë deri te identiteti i cili prezanton tepricën e kursimeve mbi investimet.
- $S - I = (G + TR - TA) + Nx$, Ana e djathtë e identitetit të mësipërm tregon tepricën e kursimeve mbi investimet ($S - I$) e cila është e barabartë me deficitin buxhetor të qeverisë ($G + TR - TA$) plus tepricën e bilancit tregtar (Nx).

Kursimet, investimet, deficit buxhetor dhe eksporti neto në një ekonomi të supozuar (në 000.000 \$)

Kursimi (S)	Investimet (I)	Deficit buxhetor (BD)	Eksporti neto (Nx)
500	500	0	0
500	400	100	0
500	300	0	200
500	700	50	- 250

VII. TREGU I PUNES DHE PAPUNËSIA

Punesimi si faktore kryesore dhe karakteristikat e tij:

- Punesimi paraqet indikatorin me te rendesishem makroekonomik te nje vendi.
- Normat e larta te punesimit krijone stabilitet te pergjitheshem ekonomiko-shoqerore, **perderisa, normat e uleta te punesimit paraqesin vatra te tensioneve sociale.**
- **Normat e papunësisë dhe niveli i papunësisimit janë prezentues më të saktë të zhvillimit ekonomik dhe barazisë kombëtare dhe pse jo edhe të barazimit gjinorë.**
- Punesimi pervec efekteve ekonomike influencon edhe ndryshime demografike. P.sh norma e larte e punesimit te femrave (shtete e Evropes perendimore) dhe (shtete e Afrikes).

Kërkesa për fuqi punëtore

- Fuqia punëtore dhe kapitali paraqesin faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik.
- Kapitali varet nga investimet (amortizimi i akumuluar ne periudhë afatgjate) dhe anasjelltas, atëherë sipas jush **kërkesa për fuqia punëtore nga çka mendoni se varet?**
- investimet e reja dhe kapitali ekzistues determinojnë nivelin e kapitalit të përgjithshëm, ndërsa, Investimet në kapital determinojnë kërkesën për fuqi punëtore.
- Në kërkesën e fuqisë punëtore vendosin vetë bizneset. Siç e dimë ato kanë objektiv maksimizimi e fitimit dhe punësojnë aq punëtor derisa të arrin këtë objektiv.

Prodhimi marginal dhe kërkesa për fuqi punëtore

- firma e biznesit do të punësojë punëtor të ri deri sa të ardhurat marxhinale tejkalojnë kostot marxhinale dhe do të ndërpresë punësimin shtesë kur këto indikator barazohen mes veti ($MR = MC$).
- **bizneset** bien vendime për angazhime shtesë duke krahasuar fitimin me koston
- **individët** masin koston dhe dobinë që do të marrë nëse punësohet.


Tabela 29 - Prodhimi marginal në firmën e prodhimit të bluzave "Antigona"

Numri i punëtorëve	Numri i bluzave	Prodhimi marginal (bluzat shtesë)	Fiitimi marxhinal, (çmimi i një bluze = 30\$)
0	0		
1	15	15	450
2	28	13	390
3	39	11	330
4	48	9	270
5	55	7	210
6	60	5	150
7	63	3	90
8	64	1	30

- Prodhimi marxhinal është llogaritë duke pjesëtuar diferencën e numrit të përgjithshëm të bluzave me diferencën e numrit të përgjithshëm të punëtorëve.
- Për firmën me rëndësi është kufiri deri kur ajo ka leverdi të angazhojë fuqi punëtore!
- Lidhjen inverse midis punëtorëve dhe bluzave shtesë e tregon pjerrtësia rënëse e kurbës së prodhimit marxhinal ashtu si në grafikun vijues.
- Punëtorë shtesë mund të angazhohen deri në nivelin kur fitimi marxhinal tejkalon koston marxhinale ose fitimi është i barabartë më koston marxhinale.

Grafiku 22

Kurba e prodhimit marxhinal




OFERTA PËR FUQI PUNËTORE

- Oferta agregate paraqet shumën e të gjitha ofertave individuale në një ekonomi kombëtare.
- Oferta per fuqipunetore përcaktohet nga **vendimet e vetë individëve** ose **antarëve të familjes**. Çdo person, vendos nëse do të angazhohet në tregun e punës ku paguhen ose do të zgjedh alternativën e kundërt.
- Kosto në ofertën e fuqisë punëtore paraqet koha e cila nuk mund të shfrytëzohet për ndonjë aktivitet tjetër dhe ajo quhet **kohë e lirë**.
- Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me **koston alternative**, të sakrifikojmë kohën e lirë për të ardhurat e realizuara dhe anasjelltas.

- Në vendimin e ofertës për fuqi punëtore **mëditja** është faktor determinues dhe ai ndikon në dy mënyra:
- **së pari**; rritja e mëditjes e rrit ofertën e fuqisë punëtore, por vetëm në periudhën afatshkurtër,
- **së dyti**; rritja e mëditjeve e bën punëtorin më të pasur dhe në periudhë afatgjatë pasuria redukton ofertën për punë.
- **Shtimi i pasurisë** në çfarëdo forme e zvogëlon ofertën për fuqi punëtore,
- ***Pritjet për mëditjet*** e ardhshme po ashtu ndikojnë në sasinë e saj.

Grafiku 23


Kurba e ofertës për punë



- Oferta agregate e fuqisë punëtore paraqet sasinë e përgjithshme të ofertave individuale. Rritja e mëditjeve do ta rrisë ofertën e fuqisë punëtore në 2 mënyra:
- së pari, **punëtorët e punësuar do të shtonin ofertën e tyre duke** punuar orë shtesë dhe
- së dyti, **personat e papunë të motivuar nga mëditjet e rritura** do të pranonin të punësohen. Siç mund të vërejmë nga grafiku 23 kurba e ofertës për fuqi punëtore, në fillim është gati e sheshtë dhe sa vjen e bëhet më e pjerrët. Kjo tregon se në periudha afatgjata mëditjet rriten shumë më tepër krahasuar me numrin e punëtorëve të cilët ofrojnë punë.


Grafiku 24

Zhvendosja e kurbës së ofertës për punë



Grafiku 25

Ekulibri i tregut të fuqisë punëtore



KUPTIMI DHE MATJA E PAPUNËSISË


- **Të papunë** janë personat të cilët janë të aftë dhe aktivisht kërkojnë punë, por nuk mund ta gjejnë atë.
- **Personat e punësuar dhe ato që kërkojnë punë formojnë *forcën punëtore*, në një ekonomi kombëtare. (Forca punëtore = Punësimi + papunësia).**
- Me fjalë të tjera, norma e papunësisë tregon % e forcës punëtore e cila nuk është e punësuar. (Norma e papunësisë = numri i personave të papunë / Forcën punëtore x 100).
- Norma natyrore e papunësisë tregon gjendje në të cilën tregjet e punës dhe të mirave janë të balancuara. ***Ajo asnjëherë nuk është e barabartë me zero, dhe kur ekonomia punon në punëzënien e plotë.***

Kostoja e papunësisë

- ***Kostot ekonomike*** - prezantojnë diferencën e PBB-së aktual dhe atij potencial
- ***Kostot sociale*** prezantojnë gjendjen psikologjike të të papunëve.

Grafiku 26

Prurjet dhe derdhjet e forcës punëtore në një ekonomi kombëtare



Kostot e papunësisë

- **Kostot ekonomike të papunësisë** prezantojnë diferencën e PBB-së aktual dhe atij potencial.
- **Kostot sociale prezantojnë gjendjen psikologjike të të papunëve.** *Njeriu i papunë shpesh vuan nga tensioni, zemra dhe sëmundje të tjera, sepse është depresiv për paratë dhe kohën e humbur gjatë shkollimit.*
- Sipas një studimi të realizuar nga Kongresi Amerikan, është arritur në përfundim se një rritje e zgjatur e normës së papunësisë, nga 6 në 7 %, shpie mesatarisht në:
 - 925 vetëvrasje,
 - 648 vrasje,
 - 20.240 sulme fatale në zemër,
 - 495 të vdekur nga cirroza në mëlçi,
 - 4227 pacient në spitale mentale,
 - 3340 burgosje të reja.²⁸

Tabela 30 - Ecuria e normave të papunësisë në disa shtete gjatë periudhës 2004, 2008, 2012 dhe 2015


	2004	2008	2012	2015
Gjermania	11.7	8.7	5.2	4.7
Shqipëria	14.5	13.2	13.2	16.9'
Sërbia	31.6	29.9	20.1	16.8''
Norvegjia	3.9	1.7	3.5	4.1
Italia	8.0	6.7	12.7	12.4
Sllovenia	10.8	-	9.9	9.3
Suedia	5.5	2.5	8.0	7.7
Greqia	10.2	7.2	28.0	25.5
Franca	8.8	6.4	10.8	10.5
R Çeke	9.5	-	6.9	5.9
Austria	7.1	5.8	4.8	5.7
Australia	5.5	4.2	6.0	6.0
Kosova	38.7	-	45.3	45.3'
Maqedonia	37.2	34.3	28.7	28.4

Format e papunësisë

- ***Papunësia ciklike e cila shfaqet nga lëvizjet ciklike të ekonomisë.*** Kemi cek më parë se papunësia është anticiklike, pra lëviz në drejtim të kundërt me ciklin.
- ***Papunësia fraksionale është pasojë e ndryshimeve afatshkurta në tregun e punës, që rezulton nga kërkimi i vendeve më të mira të punës.***
- ***Papunësia strukturore është pasojë e mospërputhjes së ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore në periudha të gjata kohore.***
- ***Papunësia sezonale*** paraqitet gjatë sezoneve të caktuara brenda vitit.
- **PAPUNËSIA E VULLNETSHME DHE E DETYRUAR**

Grafiku 27

Papunësia e vullnetshme (a) dhe papunësia e detyruar (b)



NORMA NATYRORE E PAPUNËSISË

- Norma natyrore e papunësisë tregon gjendje në të cilën tregjet e punës dhe të mirave janë të balancuara.
- ***Ajo asnjëherë nuk është e barabartë me zero, dhe kur ekonomia punon në punëzënien e plotë.***
- ***Me fjalë të tjera, edhe*** pse ka punë për të gjithë, një pjesë e të papunëve të cilët paraqiten në entin e punësimit, realisht nuk duan të punojnë. Norma natyrore e papunësisë lëviz në kufirin prej 3 deri në 5 %.
- Faktorët që kanë ndikuar në ecuritë e tilla janë:
 - Moshat e reja të imigrantëve të ardhur nga vendet jo mjaft të zhvilluara.
 - Përcaktimi i pagave minimale, transferet qeveritare sigurimet nga
 - papunësia etj.
 - Papunësia strukturore në rritje të vazhduar etj

VIII. PARAJA DHE BANKA QENDRORE

- **Paraja në ekonomi u paraqit në një nivel të caktuar të zhvillimit ekonomiko-shoqëror.** Rolin e saj në fazat e hershme të zhvillimit ekonomik e luajtën objekte të ndryshme, si p.sh.: lëkura, guaskat, kripa, bakri, bronzi, e më vonë metalet e çmuara (ari).
- **KUPTIMI I PARASË** - *Paraja është mjet ligjor i pagesave në një ekonomi kombëtare e më gjerë. Ajo është dekretuar nga shteti dhe ka emër, stemën, simbolet dhe elemente të tjera.*

Denari, Leku, Euroja, Franga zvicerane, Dollari, janë para të Maqedonisë, Shqipërisë, Eurozonës, Zvicrës, dhe SHBA-ve.

Funksionet e parasë

- *Paraja si masë e vlerës*
- *Paraja si mjet qarkullimi*
- *Paraja si ruajtës i pasurisë (thesar)*
- *Paraja si mjet pagese*
- *Paraja si mjet likuiditeti*

MASA MONETARE

- Në masën monetare, paraja e gatshme ka një rol të rëndësishëm. Paratë letër dhe paratë metalike që ju i keni në xhepat tuaja janë pjesë e sasisë së parasë në ekonominë tuaj kombëtare.
- *Bilancet në llogaritë rrjedhëse janë pjesë e fondit të parave në një ekonomi kombëtare.*
- *Pasuritë në llogaritë rrjedhëse të cilat quhen depozita në para (të paafatizuara), janë gati njëjloj si paratë që ju i keni në xhep.*

- Në ekonominë më të fuqishme të botës, në SHBA, fondi i parave matet me katër agregat monetar. Ato janë: M0, M1, M2 dhe M3.
- **M0 - prezanton paratë e gatshme dhe monedhat.**
- **M1 - përfshin paratë e gatshme dhe monedhat (M0), dollarin i cili**
 - qarkullon jashtë shtetit, çeqet e udhëtarëve, depozitat paafatizuara dhe depozitat e tjera.
- **M2 - përfshin të gjitha ofertat monetare të M0 dhe M1. Si mjete kryesore të M2 janë depozitat e kursimeve me afat fiks me vlerë nën 1.000.000 \$, si dhe investimet afatshkurtër në tregun e letrave me vlerë.**
- **M3 - përfshin ofertat e sipërpërmendura (M0, M1 dhe M2) plus depozitat** me afat të gjatë me vlerë mbi 1.000.000 \$ dhe fondet institucionale
- **M4 – përfshin M3 dhe aktivet tjera afatgjate, si p.sh., triskat e thesarit.**

- *Ekonomistët pajtohen se efektet e sipërpërmendura të politikës ekspansioniste monetare i takojnë periudhës afatshkurtër dhe në periudha afatgjata kohore, rritja e ofertës monetare rezulton me rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit).*
- Sipas monetaristëve, faktorët monetar kanë rrolin kryesor në ekonomi, sipas tyre oferta e parasë dhe PBB nominal kanë lidhje të forta korelative. Me fjalë të tjera, rritja e ofertës monetare rrit kërkesën agregate dhe rritja e kësaj të fundit rrit PBB nominal dhe anasjelltas.

$$MV = PQ.$$

M – tregon ofertën e parasë, V – shpejtësinë e qarkullimit të parasë, P - nivelin e çmimeve dhe Q – sasinë e përgjithshme të të mirave dhe shërbimeve në një ekonomi.

- Siç mund të vërehet depozitat monetare zvogëlojnë sasinë e parasë kesh.
- Nga kjo rrjedh se bankat sa më shumë kredi të japin aq më shumë rritet fitimi i tyre. Bankat duhet të jenë likuide, që nënkupton shlyerjen e obligimeve me kohë ndaj klientëve të saj.
- **Multiplikatori monetar – *multiplikatori monetar, paraqet shumën e parave që gjeneron sistemi bankar për çdo njësi monetare të zvogëluara për rezervat e detyrueshme.***
- **Depozitat e përgjithshme janë baras me:**

$$TD = ID \times 1/RR \times 100 \quad (TD = ID \times 1 / RR \times 100)$$
- Multiplikatori ka lidhje pozitive me depozitat dhe lidhje inverse me rezervat e detyrueshme.
- *Me rezerva të detyrueshme kuptojmë pjesën e depozitave të bankave të nivelit të dytë (Bankat Komerciale) të cilat nuk huazohen, por mbahen rezervë te Banka Qendrore.*

Multiplikatori (shumzuesi) monetar në një bankë të supozuar

	Aktiva		Pasiva	
Banka e I	Rezervat	1.000.000	Depozitat	1.000.000
	Kredit	900.000		
Banka e II	Rezervat	900.000	Depozitat	900.000
	Kredit	810.000		
Banka e III	Rezervat	810.000	Depozitat	810.000
	Kredit	729.000		
Banka e IV	Rezervat	729.000	Depozitat	729.000
	Kredit	656.100		
Banka e IV	Rezervat	656.100	Depozitat	656.100
	Kredit	590.490		
Banka e	
Oferta e përgjithshme e parasë	10.000.000		10.000.000	

KËRKESA PËR PARA

- **Niveli i çmimeve** ka lidhje korelative me sasinë e parasë.
- ***Të ardhurat reale mund të rrisin ose të zvogëlojnë kërkesën për para*** - lidhja pozitive tregon se rritja e të ardhurave rrit kërkesën për para dhe anasjelltas.
- ***Norma e interesit është faktor tjetër tejet ndikues në nivelin e kërkuar të parasë.***
- ***Pasuria rrit kërkesën për para*** dhe anasjelltas.
- ***Risku*** ka efekt të fuqishëm në kërkesën për para
- ***Likuiditeti i mjeteve alternative*** ka lidhje inverse me kërkesën për para.
- ***Bankomatet janë makina nga të cilat mund të nxjerrim para në çdo vend dhe çdo kohë, prandaj ato reduktojnë kërkesën për para***

ROLI I BANKËS QENDRORE

- ***Banka Qendrore, si institucion më i lartë monetar,*** kontrollon tërë sistemin bankar të një vendi. Ajo, cakton normat e interesit, është përgjegjëse për likuiditetin e brendshëm dhe të jashtëm, përcakton kursin devizor, udhëheq me rezervat devizore të shtetit, është bankë e qeverisë etj.
- ***Banka Qendrore, emiton para dhe rregullon ofertën për para.*** Nëse ajo, vlerëson se sasia e parave në qarkullim është e tepërt dhe mund të shkaktojë inflacion, ajo tërheq sasinë e parasë nga publiku dhe anasjelltas. Operacionet e tilla, realizohen në tregun e hapur duke shit-ble letra me vlerë .

Banka Popullore në kuadër të të drejtave dhe obligimeve, kryen funksionet si më poshtë:

- - Përgatit dhe realizon politikën monetare në shkallë vendi.
- - Rregullon likuiditetin e sistemit bankar.
- - Merr pjesë në realizimin e regjimit të kursit devizor të denarit.
- - I ruan dhe menaxhon me rezervat devizore.
- - Evidenton dhe përcjell operacionet kreditore me ekonomitë e huaja dhe përgatit bilancin e pagesave të ekonomisë vendore.
- - Koordinon me pagesat dhe llogaritë mes bankave dhe realizon distribuimin e parave të gatshme.
- - Emiton monedha dhe kartë monedha.
- - Realizon aktivitete në llogari të organeve qeveritare.
- - E përfaqëson shtetin në institucionet financiare ndërkombëtare.
- - Jep leje për këmbimoret dhe institucioneve të tjera financiare.
- - Realizon supervizion. Rregullon dhe kontrollon dhënien e parave elektronike.
- - Organizon oferta të letrave me vlerë nëpërmjet sportelit etj.

INSTRUMENTET MONETARE TË BANKËS QENDRORE

- - **Politikën e rezervave të detyrueshme.**

është operacion indirekt i Bankës Qendrore i kontrollit të ofertës monetare. Rezervat e detyrueshme janë pjesë e depozitave të bankave komerciale, të cilat nuk shfrytëzohen për të dhënë kredi, por ruhen te Banka Qendrore, ato janë të përcaktuara me ligj.

- - **Politikën e tregut të hapur**

Politika e tregut të hapur – është instrument indirekt i Bankës Qendrore për të rregulluar ofertën monetare.

- - **Politikën e normave diskontuese të interesit**

Është operacion indirekt i Bankës Qendrore i kontrollit të ofertës monetare. Bankat komerciale për të siguruar likuiditetin e vetë ose për të rrit potencialin kreditor, mund të marrin kredi nga Bankat Qendrore me normë të caktuar të interesit e cila quhet normë diskonte.

- - **kontrolli i kredisë dhe normave të interesit**

Kontrolli i kredisë dhe normave të interesit janë instrumente të drejtpërdrejta të Bankës Qendrore, dhe zbatohen në ekonomitë me transformime të thella monetare (ekonomitë jo mjaft të zhvilluara dhe ato të tranzicionit).

